

Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore, 2023

Tiranë, më 23 Prill 2025

Burimet e brendshme natyrore

Në vitin 2023, lënda e parë e nxjerrë nga burimet e brendshme natyrore, e cila përfaqëson sasinë totale të materialeve që përdoren direkt në ekonomi, është rreth 20,5 milionë tonë, duke shënuar një rritje prej 1,3 %, krahasuar me vitin 2022.


Tab. 1 Burimet e brendshme natyrore, në mijë tonë

Viti	2022	2023
Biomasa	7.053,3	6.753,4
Mineralet dhe koncentratet metalike	2.045,8	1.624,1
Mineralet jo metalike	10.018,9	10.845,1
Materialet fosile të energjisë	1.070,1	1.225,5
Gjithsej	20.188,2	20.448,1

Burimi i të dhënave: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, përpunimi i INSTAT

Struktura e burimeve të brendshme natyrore, tregon që produktet “minerale jo metalike” zënë rreth 53 %, “biomasa” 33 %, “mineralet dhe koncentratet metalike” 8 % dhe “materialet e energjisë fosile” 6 % të materialeve gjithsej.

Fig.1 Struktura e burimeve të brendshme natyrore, në %



Burimi i të dhënave: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, përpunimi i INSTAT

Për publikim 23/04/2025

Importet e materialeve mjedisore, në vitin 2023 arritën një vlerë prej rreth 5,5 milionë tonë, e cila krahasuar me vitin 2022 ka pësuar një rritje prej 8,19 %. Ndikimin më të madh në këtë rritje të importeve të materialeve mjedisore e kanë dhënë “mineralet dhe koncentratet metalike” me një rritje prej 10,80 %, “materialet fosile të energjisë” me 9,37 %, “minerale jometalike” me 7,97 %, “biomasa” me 7,02 % dhe “produkte të tjera dhe mbetje të importuara” me 1,63 %.

Tab. 2 Importet e materialeve mjedisore në mijë tonë

Viti	2022	2023
Biomasa	1.414,7	1.514,0
Mineralet dhe koncentratet metalike	1.119,3	1.240,2
Mineralet jo metalike	1.166,9	1.259,8
Materialet fosile të energjisë	1.045,7	1.143,8
Produkte të tjera dhe mbetje të importuara	343,2	348,8
Gjithsej	5.089,9	5.506,6

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Përpunoi: Instituti i Statistikave (INSTAT)

Eksportet e materialeve mjedisore në vitin 2023 arritën një vlerë prej rreth 4,2 milionë tonë, duke pësuar një rritje prej 8,53 %, krahasuar me vitin 2022. Ndikim më të madh në këtë rritje e ka dhënë kategoria “mineralet jo metalike” eksportet e të cilave shënuan një rritje prej 25,86 %. Gjatë vitit 2023, kanë pësuar rënie eksportet në kategoritë “mineralet dhe koncentratet metalike” me 6,56 % dhe “biomasa” me një rënie prej 4,29%. Nga ana tjetër eksportet e kategorive “mineralet fosile të energjisë” dhe “produkte të tjera dhe mbetjet e eksportuara” kanë pasur një rritje 17,40 % dhe 3,69 %.


Tab. 3 Eksportet e materialeve mjedisore, në mijë tonë

Viti	2022	2023
Biomasa	511,2	489,3
Mineralet dhe koncentratet metalike	1.214,0	1.1324,4
Mineralet jo metalike	1.051,9	1.324,0
Materialet fosile të energjisë	883,6	1.037,4
Produkte të tjera dhe mbetje të eksportuara	249,9	259,1
Gjithsej	3.910,7	4.244,2

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Përpunoi: Instituti i Statistikave (INSTAT)

Bilanci fizik tregtar i cili tregon diferencën midis importeve dhe eksporteve për të gjithë kategoritë e materialeve mjedisore, në vitin 2023, arriti vlerën e rreth 1.3 mijë tonë, duke pësuar rritje me rreth 83 mijë tonë, krahasuar me vitin 2022. Siç mund të vërehet në Figurën 2, për vitin 2023, produktet e “biomasës”, “materialeve fosile të energjisë”, “mineralet dhe koncentratet metalike” dhe “produktet e tjera dhe mbetjet” kanë bilanc tregtar pozitiv ndërsa produktet “mineralet jo metalike” kanë bilanc tregtar negativ.

Fig.2 Bilanci fizik tregtar, mijë tonë



Burimi i të dhënave: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, përpunim i INSTAT

Tabela 4 tregon varësinë nga importi i materialeve mjedisore, e cila në ekonominë Shqiptare llogaritet si raport ndërmjet importeve të materialeve mjedisore dhe inputeve direkte të materialeve (IDM). IDM vlerësohet si shuma e materialeve të nxjerra nga burimet e brendshme natyrore dhe importeve të materialeve.

Gjatë vitit 2023, varësia nga importi i materialeve u vlerësua në 21,1 %, duke shënuar një rritje prej 1,1 pikë përqindje, në krahasim me një vit më parë. Gjatë periudhës 2019 – 2023 varësia nga importi i materialeve ka variuar në kufijtë prej 17,8 % në vitin 2019, deri në 21,2 % në vitin 2023.

Në vitin 2023, materialet fosile të energjisë kishin varësinë më të lartë nga importi, me rreth 48,3 %, të ndjekura nga mineralet dhe koncentratet metalike me 43,3 %. Nga ana tjetër varësinë më të ulët nga importet e kanë shënuar kategoria mineralet jo metalike me 10,4 %, të ndjekura nga inputet e biomasës me 18,3 %.

Tab. 4 Varësia nga importi i materialeve, në %

Viti	2022	2023
Biomasa	16,7	18,3
Minerale dhe koncentratet metalike	35,4	43,3
Minerale jo metalike	10,4	10,4
Materialet fosile të energjisë	49,4	48,3
Gjithsej	20,1	21,2

Burimi i të dhënave: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, përpunim i INSTAT

Përdorimi i brendshëm i materialeve mjedisore

Përdorimi i brendshëm i materialeve mjedisore mat sasinë totale vjetore të lëndëve të para që nxirren nga mjedisi, duke marrë në konsideratë dhe bilancin fizik tregtar. Në vitin 2023, përdorimi i brendshëm i materialeve mjedisore arriti vlerën e rreth 21,7 milionë ton, 1,6 % më i lartë, krahasuar me vitin 2022.


Tab.5 Përdorimi i brendshëm i materialeve mjedisore, në mijë tonë

Viti	2022	2023
Biomasa	7.957,8	7.777,8
Mineralet dhe koncentratet metalik	1.951,1	1.729,9
Mineralet jo metalike	10.133,9	10.781,0
Materialet fosile të energjisë	1.232,3	1.331,8
Produkte të tjera dhe mbetje	93,2	89,6
Gjithsej	21.367,4	21,710.0

Burimi i të dhënave: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, përpunim i INSTAT

Sipas strukturës, shohim që pjesën më të madhe të përdorimit të brendshëm të materialeve mjedisore e zënë “mineralet jo metalike” me 50 %, “produktet e biomasës” me 36 %, “koncentratet metalike” me 8 % dhe “materialet fosile të energjisë” me 6 % shoqëruar nga “produktet të tjera” me 0,4 %.

Fig. 3 Struktura e përdorimit të brendshëm të materialeve mjedisore 2023, në %



Burimi i të dhënave: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, përpunim i INSTAT

Përdorimi i brendshëm i materialeve mjedisore në raport me popullsinë u vlerësua në 9 tonë / banor, duke shënuar një rritje prej 1,3 tonë / banor, krahasuar me vitin 2022, kur kjo vlerë ishte rreth 7,7 tonë / banor.


Tab.6 Përdorimi i brendshëm i materialeve mjedisore në raport me popullsinë, në tonë / banor

Viti	2022	2023
Biomasa	2,9	3,2
Mineralet dhe koncentratet metalike	0,7	0,7
Mineralet jo metalike	3,6	4,5
Materialet fosile të energjisë	0,4	0,6
Produkte të tjera dhe mbetje	0,0	0,0
Gjithsej	7,7	9,0

Burimi i të dhënave: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, përpunim i INSTAT

Produktiviteti i burimeve në ekonominë shqiptare llogaritet si raporti ndërmjet prodhimit të brendshëm bruto dhe përdorimit të brendshëm të materialeve mjedisore. Ky raport përfaqëson shumën e lekëve të gjeneruara për çdo kilogram material mjedisor që hyn në ekonominë e vendit. Në vitin 2023, produktiviteti i burimeve arriti vlerën prej 109 Lekë / kg, duke shënuar një rritje prej 9 Lekë / kg, krahasuar me vitin paraardhës.

Fig.4 Produktiviteti i burimeve 2013 – 2023, në Lekë / kg



Burimi i të dhënave: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, përpunim i INSTAT

Metodologjia

Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore është një nga modulet e Llogarive Ekonomike në Mjedis. Qëllimi i tyre është integrimi i informacionit mjedisor në një mënyrë koherente me sistemin qendror të Llogarive Kombëtare.

Llogaritë e flukseve të materialeve mjedisore ka për objekt kryesor të përshkruaj lidhjen midis ekonomisë vendase dhe mjedisit natyror. Ajo përfshin sasinë totale të burimeve natyrore dhe produkteve të përdorura në ekonomi, në mënyrë direkte në prodhimin dhe shpërndarjen e produkteve dhe shërbimeve, ose indirekt përmes nxjerrjes së materialeve të cilat do të përdoren për prodhim.

Këto të dhëna janë subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/> Disa nga kategoritë kryesore dhe indikatorët kryesorë të llogarive të flukseve të materialeve mjedisore janë:

Biomasa

Biomasa përfshin materialet organike jo fosile me origjinë biologjike. Sipas përkufizimeve të Llogarive të Flukseve të Materialeve Mjedisore, lënda e parë e nxjerrë nga burimet natyrore përfshin të gjithë produktet bujqësore, peshqit dhe kafshët e gjuetisë. Blegtoria dhe produktet blegtorale (si p.sh qumështi, mishi, vezët) nuk përfshihen në këtë kategori.

Mineralet metalike dhe mineralet jo metalike

Mineralet metalike dhe mineralet jo metalike të përpunuara dhe të pa përpunuara janë dy grupe kryesore në kategoritë e materialeve mjedisore, sipas përkufizimeve të Llogarive të Flukseve Materiale Mjedisore, që përbëhen nga prodhimet e minierave, industria e ndërtimit dhe mineralet industriale.

Materialet Fosile të Energjisë

Përfshijnë burimet e naftës dhe materialet e tjera fosile të energjisë që janë formuara në të kaluarën gjeologjike, nga biomasa. Ato përfshijnë lëndet e ngurta, lëngjet dhe gazet.

Lënda e parë e nxjerrë nga burimet natyrore

Lënda e parë e nxjerrë nga burimet natyrore përfshin sasinë vjetore të lëndëve të para (me përjashtim të ujit dhe ajrit) të nxjerra nga mjedisi natyror për t'u përdorur në ekonomi për qëllime ekonomike.

Përdorimi i brendshëm i materialeve mjedisore

Përdorimi i brendshëm i materialeve mjedisore mat shumën vjetore të lëndëve të para të nxjerra dhe të përdorura në ekonominë kombëtare, plus të gjitha importet fizike, minus të gjitha eksportet fizike.

Bilanci i Fizik Tregtar

Bilanci fizik tregtar është i barabartë me importet fizike minus eksportet fizike.

Varësia nga importi i materialeve (VI): llogaritet si raport i importeve mbi inputet direkte të materialeve (IDM), në përqindje. Termi 'varësia nga importet e materialeve' tregon shkallën në të cilën një ekonomi mbështetet në importe për të përmbushur nevojat e saj për materiale. Varësia nga importet e materialeve nuk mund të jetë negative ose më e lartë se 100%. Vlerat e barabarta me 100% tregojnë se nuk ka patur nxjerrje nga burimet e brendshme natyrore gjatë vitit të referimit.

$$VI = \frac{\text{Importe}}{(\text{Burimet e brendshme} + \text{Importe})}$$

Produktiviteti i burimeve përcakton një tregues që pasqyron PBB-në e gjeneruar për njësi të burimeve të përdorura nga ekonomia.

Burimi i të dhënave

Te dhënat e përdorura për Llogaritë e flukseve të Materialeve Mjedisore kanë burim të dhëna administrative të marra nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU), Instituti i Statistikave (INSTAT) etj.

Metodologjia e përdorur për llogaritjen e tyre është bërë në përputhje me rregulloren (BE) Nr 691/2011 mbi Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore dhe manualeve të Eurostat.